



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 289/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha

Vilma Zhupaj

Merita Zeqaj

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. në procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-06170-02-04-2019 me objekt, “Shërbim i ruajtjes së objekteve me roje private Sh. A Ujësjetllës Kanalizime Librazhd”, me fond limit 20.015.540 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 07.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Sh. a Ujësjetllës Kanalizime Librazhd.

Gjithashtu operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. ngre pretendime mbi ofertën e operatorit ekonomik “Kumria 1” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k., “Bahiti – G” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k., ngre pretendime mbi ofertën e operatorëve ekonomikë “Uevi -2015” sh.p.k., “Eurogjici Security” sh.p.k., “Bahiti” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Eurogjici Security”shpk
Adresa: Rruga “Adem Jashari”, Lgjia 8, H. 10, Ap.3,Tiranë

“Nazeri 2000” sh.p.k
Adresa: Rruga “e Kavajës”, Qendra Condor, Kati II, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Librazhd
Adresa: Sheshi i Agjensisë Librazhd

Subjekt i Interesuar: “Kumria 1” sh.p.k.
Adresa: Rruga”Shefqet Daiu” Lagjia “11 Nëntori” Banesë
Private Nr.21 Elbasan

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 05.02.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-06170-02-04-2019 me objekt, “Shërbim i ruajtjes së objekteve me roje private Sh. A Ujësjiellës Kanalizime Librazhd”, me fond limit 20.015.540 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 07.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Sh. a Ujësjiellës Kanalizime Librazhd.

II.2. Në datën 19.03.2019 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 19.03.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. Uevi-2015	18.871.687.20	I skualifikuar
2. Eurogjici Security	19.836.259,89	I skualifikuar
3. Kumria1	19.836.259,90	I kualifikuar
4. Bahiti G	19.836.259,90	I skualifikuar
5. Nazeri 2000	19.836.259,90	I skualifikuar

II.4. Në datën 19.03.2019 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

-Nuk plotëson kërkesën 2.3.3, pasi nuk ka paraqitur ne vërtetimin e DV Policisë 15 çertifikata të punonjësve të vlefshme konform Ligjit 75/2014 me afatit 4-vjeçar nënkategoria 1.3.A; -

Nuk plotëson kërkesën 2.3.2, pasi nuk mbulon me frekuenca nga AKEP për radiokomunikim dhe alarm për vendin e kryerjes së shërbimit Depo Ujit pishëm Qaf Thanë;

- Nuk plotëson kërkesën 2.3.3, pasi nuk ka grup të gatshëm sipas kërkesës autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD;

-Nuk ka respektuar kërkesën për kualifikim AK pika 2.3.7 plotësimi dhe dorëzimi i formularit të ofertës sipas Shtojcës 1 të DT

II.5. Në datën 20.03.2019 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmblodhur me argumentet si më poshtë:

[...]Ne datën 19.03.2019. nepermjet SPE jemi njoftuar per renditjen si ne vijim:

Autoriteti Kontraktues Sh.A Ujesjelles Kanalizime Librazhd

Subjekti Vleresimet per tenderin "Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private" (Faza e vleresimit të tenderit)

Vleresimet per tenderrn "Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private" (Faza e vleresimit të tenderit)

1.	Uevi-2015	18.871.687.20	I skualifikuar
2.	Eurogjici Security	19.836.259,89	I skualifikuar
3.	Kumria1	19.836.259,90	I kualifikuar
4.	Bahiti G	19.836.259,90	I skualifikuar
5.	Nazeri 2000	19.836.259,90	I skualifikuar

EUROGJICI

Pershendetje Operator Ekonomik,

Oferta juaj OFFER-5240/20022019 per tenderin REF-06170-02-04-2019 "Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private" eshte refuzuar.

REASONS:

Nuk plotëson kërkesën 2.3.3, pasi nuk ka paraqitur ne vërtetimin e DV Policisë 15 çertifikata të punonjësve të vlefshme konform Ligjit 75/2014 me afatit 4-vjeçar nënkategoria 1.3.A;

- Nuk plotëson kërkesën 2.3.2, pasi nuk mbulon me

frekuenca nga AKEP për radiokomunikim dhe alarm për vendin e kryerjes së shërbimit Depo Ujit pishëm Qaf Thanë;

- Nuk plotëson kërkesën 2.3.3, pasi nuk ka grup të gatshëm sipas kërkesës autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD;

-Nuk ka respektuar kërkesën për kualifikim AK pika 2.3.7 plotësimi dhe dorëzimi i formularit të ofertës sipas Shtojcës 1 të DT.

Kundështojmë arsyen e parë të skualifikimit.

Nuk plotëson kërkesën 2.3.3, pasi nuk ka paraqitur ne vërtetimin e DV Policisë 15 çertifikata të punonjësve të vlefshme konform Ligjit 75/2014 me afatit 4-vjeçar nënkategoria 1.3.A;

Referojmë nenin 46 pika 1 gërma b të LPP-së[...] nenin 53 ika 3 të LPP-së[....]Nenin 55 pika 2 të LPP-së[...]

Referojmë Kreu II "Procedurat për Trajnimin dhe ritarjimin e Personelit të Shpsf-së Shronja B, Llojet e certifikatave dhe dëshmime që jepen nga institucionet e trajtimit të Udhëzimit nr. 505 datë 26.10.20118 "PËR Qendrat e Trajnimit Privat"[...] Kreun IV Dispozitat Kalimtare dhe të fundit të udhëzimit[...] Kreu IV të udhëzimit 130 datë 05.03.2018 [...]

Referuar punonjesve të shërbimit të paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Publike (SPE). ata Jane:

- 1. Gezim KOTORRI, me Certificate Nr.349, date 26.12.2018;*
- 2. Beqir KAMAMI, me Certificate Nr.348, date 26.12.2018;*
- 3. Petrit LICI, me Certificate Nr.310, date 19.03.2018;*
- 4. Ferit DHEPA, me Certificate Nr.37 1. date 26.12.2018;*
- 5. Sefer AGO, me Certificate Nr.350, date 16.04.2015;*
- 6. Albert KASNECI, me Certificate Nr.371, date 17.07.2018;*
- 7. Elmas ISAKU, me Certificate Nr.365, date 17.07.2018;*
- 8. Enver ABAZI, me Certificate Nr.020. date 24.11.2015;*
- 9. Diku KLLOGJERI, me Certificate Nr.472, date 08.02.2019;*
- 10. Klevin GJEKA, me Certificate Nr.543. date 01.03.2019, 1 1. Gezim SADJA, me Certificate Nr.070, date 16.03.2016;*
- 12. Xhoni D1KA, me Certificate Nr.343, date 19.06.2018;*
- 13. Idris LLAKA. me Certificate Nr.663, date 31.12.2013;*
- 14. Avni LALA, me Certificate Nr.398, date 30.01.2012;*
- 15. Rasim OMERI, me Certificate Nr.549. date 27.02.2013;*
- 16. Faslli BAKU, me Certificate Nr.294, date 23.02.2015;*

Punonjesit e shërbimit Idris LLAKA, Avni LALA. Rasim OMERI dhe Faslli BAKU, kane ushtruar kete funksion ne daten e hyrjes ne fuqi të Udhëzimit Nr.505, Date 26.10.2018 "Per Qendrat e Trajnimit Privat" per rrjedhoje të gjithë kane afat 2 vjet nga hyrja ne fuqi e ketij udhezimi, per tu pajisur me Dëshmi Afësie. sipas ligjit nr. 75/2014, dhe ti nënshtrohen certifikimit sipas ketij udhezimi.

Nga sa me riper, arsyeja e skualifikimit të shoqërisë sone është teresisht ne kundërshtim me dispozitat ligjore të referuara me sipër dhe për këtë arsye duhet të anulohet.

Kundërshtojmë arsyen e dytë të skualifikimit se Nuk plotëson kërkesën 2.3.2, pasi nuk mbulon me frekuencë nga AKEP për radiokomunikim dhe alarm për vendin e kryerjes së shërbimit Depo Ujit pishëm Qaf Thanë;

Ne Kriteret e Vecanta të Kualifikimit përcaktohet kriteri si në poshtë:

"Autorizim individual nga AKEP për caktimi frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr.9918, date 19.05.2008"Per komunikimin elektronik të RSh " me zone mbulimi vendi ku do të kryhet shërbimi ".

Rezulton se në përmbushje të kriterit të kualifikimit, shoqëria jone ka paraqitur në SPE:

- Autorizim Individual Nr.522, date 18.02.2019, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektrike dhe Postare (AKEP), me zone mbulimi Radiokomunikimi Elbasan, Peqin. Cerrik, Belsh. Granrsh. Librazhd - 45 Kilometer:*

- *Autorizint Individual Nr.522, date 18.02.2019, liishuar nga Atrtoriteti i Kumunikinteve Elektronike dhe Postare (AKEP), me zone mbulimi Radialarm Elbasan, Peqin, Cerrik, Belsh. Gramsh. Libruzhd 45 Kilometer;*

Referojmë nenin 46 pika 1 gërma b të LPP-së[...] nenin 53 ika 3 të LPP-së[....]Nenin 55 pika 2 të LPP-së[...]; nenin 28 pika 5 e VKM-së 914 datë 29.12.2014 me ndryshime;

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria jonë dëshmohet qartësisht se disponojmë autorizim lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, qe ploteson kriterin e percaktuar nga autonteti kuntraktor në dokumentat e tenderit pasi me Autorizimin Individual per caktim dhe përdorim frekuencash Librazhd -45 km, referuar distancës në kilometra të përcaktuar në autorizimin individual përkatës, rezulton se ai përfshin distancën reale Qafë Thanë 27.63 . Sa më sipër pretendimi i autoritetit kontraktor është i pabazuar.

Kundështojmë arsyen e tretë të skualifikimit. Nuk plotëson kërkesën 2.3.3,pasi nuk ka grup të gatshëm sipas kërkesës autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD.

Referuar vërtetimit nr. 1757 prot datë 05.03.2019 rezulton se shoqëria jonë disponon grup të gatshëm. Sa më sipër pretendimi i autoritetit kontraktor është i pabazuar.

Kundështojmë arsyen e katërt të skualifikimit. Nuk ka respektuar kërkesën për kualifikim AK pika 2.3.7 plotësimi dhe dorëzimi i formularit të ofertës sipas Shtojcës 1 të DT.Referojmë shtojcën I “Formulari i Ofertës” të parashikuar nga ak-ja në dst[...]

Referojmë nenin 46 pika 1 gërma b të LPP-së[...] nenin 53 ika 3 të LPP-së[....]Nenin 55 pika 2 të LPP-së[...]

Referojmë nenin 55 pika 2 e LPP-së[...] Përsa më sipër skualifikimi është i paligjshëm.

Kundështojmë kualifikimin e operatorit ekonomik “Kumria I” sh.p.k për arsyet në vijim:

1.Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar:

"Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara në QKB me niptin perkates.. "
Rezulton se oe-ja nuk ka paraqitur vërtetime për të gjitha adresat dhe vitet sipas adresave të regjistruara.

2. Ne kriteret të vecanta të kualifikimit, eshte kërkuar:

2.2.2 Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara në QKB me niptin perkates..

Operatori ekonomik ka deshtuar në permbushjen e kriterit pasi nuk ka paraqitur NIPTET sipas të gjitha adresave të rregjistruara në QKB dhe sipas kërkesës së kërkuar nga autoriteti kontraktor .

3. Ne kriteret të vecanta të kualifikimit, eshte kërkuar:

“2.3.2 Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimin elektronike në RSh” me zonë mbulimi vendi ku do të kryhet shërbimi.”

Rezulton se AKEPI i paraqitur nga operatori ekonomik nuk e mbulon me frekuenca nga AKEP për radiokomunikim dhe alarm për vendin e kryerjes së shërbimit Depo Ujit pishem Qaf Thane.

4. Nuk ka qender kontrolli me grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundshme:

5. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur të vulosur dhe nenshkruara specifikimet teknike, shërbimin dhe grafikun e ekzekutimit, termat e references.

6. Certifikata e punonjësve të shërbimit të paraqitur nga operatori ekonomik nuk figurojnë të gjithë në listpagesat e shoqërisë.

Kërkojmë lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik "Nazeri 2000" sh.p.k për arsyet në vijim:

1. Operatori ekonomik në formularin e ofertës ekonomike ka gabime aritmetike të cilat kalojnë vlerën $\pm 2\%$ dhe oferta duhet të skualifikohet pasi në rastin konkret nuk pranohen korigjime të gabimeve aritmetike të cilat e kalojnë vlerën Ndost është theksuar se " - nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korigjohet. Shumat e korigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. "

2. Në kriteret e vecanta është kërkuar: Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Per komunikimin elektronike ne RSh" me zonë mbulimi vendi ku do te kryhet shërbimi.

Rezulton se AKEP i paraqitur nga operatori ekonomik nuk mbulon me frekuenca nga AKEP për radiokomunikim dhe alarm për vendin e kryerjes së shërbimit Depo e Ujit pishëm Qaf Thanë.

3. Nuk ka qendër kontrolli me grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundshme.

4. Në kriteret e vecanta është kërkuar: Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara ne QKB me niptin perkates.

Referuar ekstraktit historik të shkarkuar në faqen e QKB-së del se oe-ja në datën 15.11.2000 ka themeluar shoqërinë "Nazeri 2000" sh.p.k. me seli në adresën

Subjekti :.Nazeri 2000 Forma Ligjore: Shpk Data e themelimit: 13.11.2000 Rruga "Babe Rexha ",pall C,Shk 2,Ap 13 " Selia: Tirane

Rezulton se operatori nuk ka paragitur asnje vertetim mbi shlyerjen e taksave vendore 2017-2018 per adresen: "Tirane . Rru ka "Babe Rexha" Pall C Shk 2,j p r 1 3 "

Kujtojmë ketu se kjo adrese nuk është mbyllur asnjeher dhe per kete arsye ka qene detyre e operatorit të paraqiste vertetim nga Bashkia Tirane me ane të cilit të vertetonte se kishte shlyer taksat vendore per kete adrese e cila është ende aktive.

5. Në kriteret e vecanta është kërkuar: 2.2.2Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara ne QKB me niptin perkates.

Referuar ekstraktit historik të shkarkuar në faqen e QKB-se. del se operatori ekonomik në daten 27.02.2018 ka hequr adresën "Berat" Lagjia 3 dhjetori Rr. Babdut Karbubunara, Godina-1 Katëshe

përballë Bar-Kafe Polovina” Ndërkohë për këtë adresë operatori ka paraqitur vërtetim datë 30.07.2018, lëshuar nga Bashkia Berat me anë të cilit vërtetohet se janë shlyer taksat për të gjithë vitin 2018 por deri në datën e marrjes së vërtetimit (30.07.2018). Nga sa më sipë dokumenti nuk jep informacion se janë shlyer taksat vendore për këtë adresë për të gjithë vitin 2018.

6. Në kriteret e vecanta është kërkuar: 2.2 Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara në QKB me niptin perkates. OE-ja ka dështuar në përmbushjen e kriterit pasi nuk ka paraqitur NIPTET sipas të gjitha adresave të regjistruara në QKB dhe sipas kërkesës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

7. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur të volusa dhe të nënshkruara specifikimet teknike, shërbimin dhe grafikun e ekzekutimit, termat e referncës.

8. Certifikatat e punonjësve të shërbimit të paraqitur nga operatori ekonomik nuk figurojnë të gjithë në listëpagesat e shoqërisë.

Kërkojmë lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Bahiti-G” sh.p.k. dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit si në vijim:

1. Operatori ekonomik në formularin e ofertës ekonomike ka gabime aritmetike të cilat kalojnë vlerën $\pm 2\%$ dhe oferta duhet të skualifikohet pasi në rastin konkret nuk pranohen korigjime të gabimeve aritmetike të cilat e kalojnë këtë vlerë. Në dst është theksuar se: nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korigjohet. Shumat e korigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

2. Në kriteret e vecanta është kërkuar: 2.3.2 Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimin elektronike në RSh” me zonë mbulimi vendi ku do të kryhet shërbimi. Rezulton se AKEPI i paraqitur nga operatori ekonomik nuk mbulon me frekuencë nga AKEP për radiokomunikim dhe alarm për vendin e kryerjes së shërbimit Depo Ujit pishëm Qaf Thanë.

3. Nuk qendër kontrolli me grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundëshme.

4. Në kriteret e vecanta është kërkuar: 2.2.2 Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara në QKB me niptin perkates. Operatori ekonomik ka dështuar në përmbushjen e kriterit pasi nuk ka paraqitur NIPTET sipas të gjitha adresave të regjistruara në QKB dhe sipas kërkesës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

5. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur të volusa dhe të nënshkruara specifikimet teknike, shërbimin dhe grafikun e ekzekutimit, termat e referncës.

6. *Certifikatat e punonjësve të shërbimit të paraqitur nga operatori ekonomik bnuk figurojnë të gjithë në listëpagesat e shoqërisë.*

Si përfundim kërkojmë:

- 1)Pezullimin e procedures deri ne shqy rtimin e plote të ankeses*
- 2) Kualifikimin e shoqerise sonë, sipas arsytimit te dhene më siper.*
- 3) Skualifikimin e operatorit ekonomik "Kumria I "sh.p.k sipas percaktimeve të bera me siper;*
- 4) Lenien e skualifikuar të operatorit ekonomik "Nazeri 2000"sh.p.k dhe "Bahiti-G"sh.p.k dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit sipas referimeve të mesiperme*
- 5) Kthim Pergjigje brenda fateve të parashikuara ne nenin 63 të LPP-se.*

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 27.03.2019 me shkresën nr.53/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 28.03.2019, pala ankimuese ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 19.03.2019 operatori ekonomikë “ Nazeri 2000 ” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Nuk plotëson kërkesën 2.2.2, pasi nuk ka paraqitur niptin sekondar sipas adresave dytësore të ushtrimit aktivitetit të

deklaruara në QKB, përkatësisht:Adresa e aktivitetit Dibër, Peshkopi për vitin 2017.

II.9. Në datën 21.03.2019 operatori ekonomik “ Nazeri 2000 ” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

[...]Nepermjet kesaj ankese duam të bejme prezent nje problem qe konsiston ne shkeljet e kryera nga Autoriteti Kontrator " Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd" per proceduren e prokurimit organizuar ne date 07/03/2019 me objekt "Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private" Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd" si me poshte: Nga ana e KVO ne daten15.03.2019 ne menyre elektronike eshte derguar njoftim mbi klasifikimin e Shoqerive pjesemarrese ne kete procedure prokurimi:[...]

Sipas ketij klasifikimi rezulton se eshte skualifikuar shoqeria jone me pretendimin se " Nuk ploteson kerkesen 2.2.2, pasi nuk ka paraqitur niptin sekondar sipas adresave dytesore t ë ushtrimit aktivitetit të deklaruara ne QKB, perkatesisht:Adresa e aktivitetit Diber, Peshkopi per vitin2017"

Se pari, autoriteti duhet të kualifikoje shoqerine tone pasi arsyeja e skualifikimit nuk qendron pasi nga ana jone kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e kerkuar ne dst. Pretendimi i AK nuk qendron pasi nuk mund të skualifikohemi per nje kriter i cili nuk eshte shprehur ne dst, referuar "Neni 55 pika 2 e LPP-se parashikon se "Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per të percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nuk

duhet të perdoret asnje kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit". Ne dst ne asnje nga kerketat AK nuk ka kerkuar nipte sekonar por ka kerkuar Vertetim nga pushteti vendore (Bashkit) qe ka paguar taksat dhe tarifat vendore per vitin 2017 dhe 2018 per cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara ne QKB me niptin perkates.

-Nga ana jone per permbushjen e kerkeses se dhene kemi paraqitur taksat vendore per periudhen e kerkuar vitin 2017 dhe 2018 per cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara ne QKB me nipte perkates. Pra kerkesa e dhene ne dst eshte permbushur plotesisht nga ana jone per aq sa eshte kerkuar. Per me teper edhe sikur nga ana e AK të ishin kerkuar niptet sekonare perseri kjo kerkese permbushet pasi ne dokumentat e tenderit pervec NIPTIT të shoqerise kemi paraqitur edhe certifikaten e regjistrimit (nipte) per të gjithë adresat sekonare qe kemi të hapura sipas ekstraktit të QKB ne seksionin 15 "Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit ". Si dhe referuar vendimit të KPP-se nr. 150/2017 date 21.03.2017, per të njejtin kriter e referojmë[....]

Gjithashtu arsyeja e skualifikimit nuk qendron pasi edhe sikur të ishte kerkuar nipti sekonar perseri per sa i perket niptit sekonar "Diber, Peshkopi" per të cilin na keni skualifikuar sqarojme se ky nipt sekonar eshte mbyllur nga ana jone (kjo sipas edhe pasqyrimet ne ekstraktin e QKB) dhe referuar nenit 43 i Ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per QKR" dhe sipas dokumentacioni të kerkuar ne QKB per mbylljen e niptit sekonar kerkohet nder të tjera Kartoni i adreses sekonare qe do të mbyllet. Pra, per nje adrese të mbyllur kartoni isaj eshte pavlefshem kjo gje eshte specifikuar edhe tek certifikata e regjistrimit ku ne fund të saj shprehet "Ky dokument mbetet prone e Qendres Kombetare të Biznesit dhe duhet të kthehet ne rast se ka ndryshim të ndonje detaji ose nderpritet detyrimet ligjor per të qene person i tatueshem".

Pra, per sa shpjeguem AK nuk mund të na skualifikoje per nje kriter të pashprehur ne dst pasi niptet sekonare nuk jane kerkuar , per me teper AK nuk mund të na skualifikoje per nje dokument i cili ligjerisht eshte i pakerkueshem pasi eshte mbyllur. Te njejtin qendrim mban edhe KPP ne vendime analoge p.sh vendimin nr. 597/2018 date 12.09.2018 ku referojmë vendimin[....]

Se dyti, autoriteti duhet të skualifikoje shoqerine Kumria dhe duhet të shtojte arsye skualifikimi per shoqerine Bahiti pasi nuk kane permbushur kerkesen e AK sipas shtojces 7 "Deklarate Mbi Permbushjen E Kriterëve Te Pergjithshme" ku të shprehet per emrat e Personave ne cilesine e anetarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik qe penale, to percaktuara ne nenin 45/1 të LPP.

Se treti, Autoriteti duhet të skualitkoje shoqerine Kumria pass nuk ka permbushur kerkesen e AK sipas shtojces 1 , formulari i ofertes pasi nuk ka plotesuar cmimin total dhe afatin si dhe nuk ka plotesuar vleren totale ne shifra dhe me pershkrim me fjale.

Autoriteti duhet të skualifikoje shoqerine Kumria pasi nuk ka permbushur kerkesen e AK shtojca pika 2.3.2 pasi kjo shoqeri nuk ka paraqitur AKEP sipas kerkeses ne dst per radiokomunikim dhe alarm me zone mbulimi per vendet ku kerkohet sherbimi sipas specifikimeve teknike të dhena nga Ak ne dst tek shtojca 9 ku të perfshihet (Qarrisht, Librazhd, Prrenjas, Thane).

Autoriteti duhet të skualifikoje shoqerine Kumria pasi nuk ka permbushur kerkesen e AK shtojca 8 pika 2.2.2 pasi nuk ka paraqitur vertetim nga pushteti vendore (Bashkite) ku të kete paguar taksat dhe tarifat

vendore per vitin 2017 dhe 2018 per cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara ne QKB me niptin perkates.

Autoriteti duhet të shtojë arsye skualifikimi per shoqerite Bahiti, Eurogjici pasi nuk plotesojne piken 2.1.3 per numrin e kekruar të certifikatave të vlefshem per punonjesit e sherbimit, nuk plotesojne pike 2.3.3 pasi kane ngjarje dhe mase ne vertetimin e DPQ, si dhe nuk plotesojne piken 2.3.5 per dokumentacioni e kerkuar per numrin e armeve sipas dst si dhe duhet të skualifikohen shoqerite UEVI-2015, Eurogjici pasi jane nen kosto ligjore . Perfundimisht nga Argumentimi i bere sa me siper kerkojme nga ana e Autoritetit të behet kualifikimi i shoqerise sone pasi arsyeja e skualifikimit nuk qendron, pra skualifikimi eshte bere ne menyre të njeanshme dhe të padrejte dhe të shtojë arsye skualifikimi per shoqerite UEVI-2015, Eurogjici, Bahiti dhe të skualifikoje per shoqerine Kumria pasi nuk permbushin kerkesat e dhena ne dst.

Shpresojme qe ankesa jone të merret ne konsiderate, pasi do to jemi të detyruar ne ndjekjen e të gjitha shkalleve të tjera të ankimimit.

II.10. Në datën 27.03.2019 operatori ekonomik “ Nazeri 2000 ” sh.p.k. është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.11. Në datën 01.04.2019 pala ankimuese operatori ekonomik “ Nazeri 2000 ” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr.67/1 prot., datë 12.04.2019, protokolluar me tonën me nr. 549/2 datë 15.04.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k. mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin se: “- Nuk plotëson kërkesën 2.3.3, pasi nuk ka grup të gatshëm sipas kërkesës autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD;”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3 e “Kapacitetit teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF (Elbasan) si dhe vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan jo më vonë se 1 (nje) muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për: -Lista emërore e punonjësve të certifikuar konform Ligjit 75/2014 nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës; -Të ketë qendër kontrolli me grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundëshme; -Të ketë 1(një) përgjegjës shërbimi; -Të mos ketë masë administrative për operatorin ekonomik (subjektin) dhe drejtuesin teknik sipas përcaktimeve të nenëve 44, 45 të Ligjit.75/2014. Nuk ka ngjarje të ndodhura në objektet ku kryhet shërbimi.

Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet Objekti: “Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes” Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.

Shpërndarja: - Sipas vendndodhjes së objekteve:

Nr	Vendshërbimet	Vendroje	Turne	Nr rojeve
1	Vendroje në hyrjen kryesore pompas/depo uje Qarrisht me tre turne	1 vend roje	3 turne x 1.66 (24 orë çdo ditë kalendarike)	4.98
2	Depo Uje te pishem Librazhd	1 vend roje	2 turne x 1.66 (16 orë II-III-te çdo ditë kalendarike)	3.32
3	Depo Uje te pishem Prrenjas	1 vend roje	2 turne x 1.66 (16 orë II-III-te çdo ditë kalendarike)	3.32
4	Depo Uje te pishem Qaf Thane.	1 vend roje	2 turne x 1.66 (16 orë II-III-te çdo ditë kalendarike)	3.32

Vendndodhja e shërbimit: _____

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve të nevojshme	Afati i levrimit
1(nje)	3 (I,II,III) 24 ore çdo ditë kalendarike	4.98	24 muaj Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat përfundimtar 24 muaj.

3(tre)	2 turne (16 orë II-III-te cdo ditë kalendarike)	9.96	24 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 24 muaj.
Totali		14.94	

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj (i parashikuar)

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Eurogjici – Security” sh.p.k., për të përmbushur kriterin e mësipërm ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim nr.1757 prot., datë 05.03.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, mbi performancën e veprimtarisë së shoqërisë “Eurogjici - Security” sh.p.k. për periudhën 2017-2018.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.4. Në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V “Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF-së”, në pikën 11 dhe 13 është parashikuar:

11. Veprimtaria e SHPSF-së realizohet nëpërmjet organizimit të shërbimit me:

- a) roje objekti për ruajtjen fizike;
- b) truproje për ruajtjen e personave;
- c) sisteme sinjalizuese elektronike për ruajtjen e objekteve;
- d) punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit;

- e) punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike;
- f) përgjegjës shërbimi;
- g) punonjës shërbimi (shofer) për drejtimin e automjetit;
- h) punonjës shërbimi për drejtimin e motoçikletës;
- i) shoqërues i qenit të shërbimit.

13. Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Koha e reagimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar ofrimi i shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të Sh. A Ujësjellës Kanalizime Librazhd, shërbim ky i cili kërkohej për 1 vëndroje me tre turne (I,II,III 24 ore çdo ditë kalendarike) dhe 3 vëndroje me 2 turne, (16 orë II-III-te çdo ditë kalendarike) për një periudhë 24 muaj. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta të kualifikimit, ka përcaktuar se operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë nëpërmjet Vërtetimit të performancës të vitit 2019 të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, konform ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhëzimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, se disponojnë grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundshme.

Nisur nga kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me grupin e gatshëm, si dhe arsyeja e skualifikimit të dhënë për operatorin ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k., KPP referuar Udhëzimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V “Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF-së”, në pikën 13 parashikohet se për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më

pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Pra, referuar kësaj dispozite, operatorët ekonomikë kanë detyrimin që të vërtetojnë se kanë grup të gatshëm me 2 (dy) punonjës për çdo turn, për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, sipas shërbimit të kërkuar. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor kërkon ofrimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike për 1 vendroje me tre turne dhe 3 vendroje me dy turne për një periudhë 24 muaj.

Nisur sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. konkretisht Vërtetimit nr.1757 prot., datë 05.03.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, mbi performancën e veprimtarisë së shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. për periudhën 2017-2018, konstatohet se ky operator ekonomik ka deklaruar se ka në dispozicion 3 punonjës për verifikimin e sinjaleve të alarmit, për tre turne.

Sa më sipër argumentuar, nisur nga kërkesa e autoritetit kontraktor për grup të gatshëm për 24 orë, ku shërbimi i kërkuar është për 1 vendroje me tre turne dhe 3 vendroje me dy turne për një periudhë 24 muaj, si dhe parashikimeve ligjore, ku përcaktohet se ky grup duhet të përbëhet nga minimumi 2 punonjës për çdo turn, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. konstaton se, operatori ekonomik ankimues nuk plotëson numrin e nevojshëm të punonjësve për grup të gatshëm për verifikimin e sinjaleve të alarmit, me qëllim ofrimin e shërbimit të kërkuar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me skualifikimin e tij nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. mbi arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. mbi ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislati janë dëmtuar si rezultat i

një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. mbeten i skualifikuar në bazë të arsyetimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimeve të tij në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tij të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merret në shqyrtim.

Për rrjedhojë, këto pretendime nuk merren në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin se: *“Nuk plotëson kërkesën 2.2.2, pasi nuk ka paraqitur niptin sekondar sipas adresave dytësore të ushtrimit aktivitetit të deklaruar në QKB, përkatësisht: Adresa e aktivitetit Dibër, Peshkopi për vitin 2017.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2, *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”* nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar:

Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara në QKB me niptin përkatës.

III.4.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

“Ekstrakt Historik i Regjistrisë Tregtar për të Dhënat e Subjektit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”
 lëshuar më 22.02.2019, nga ku rezulton se zyra qendrore e shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k është Tiranë.

- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017 dhe 2018 me nr. 160254/1 prot, datë 09.07.2018, lëshuar nga Bashkia Tiranë.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 124 prot, datë 29.09.2017, lëshuar nga Bashkia Durrës.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 75 prot, datë 18.04.2018, lëshuar nga Bashkia Durrës.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 02 prot, datë 08.02.2017, lëshuar nga Bashkia Elbasan.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 282 prot, datë 28.02.2018, lëshuar nga Bashkia Elbasan.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017 dhe 2018, me nr 323 prot, datë 02.07.2018, lëshuar nga Bashkia Fier.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për periudhën deri 31.12.2017, lëshuar nga Bashkia Berat datë 10.02.2017.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 35 prot, datë 20.04.2018, lëshuar nga Bashkia Berat.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 97 prot, datë 30.07.2018, lëshuar nga Bashkia Berat.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 1/21 prot, datë 10.02.2017, lëshuar nga Bashkia Vlorë.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 1876 prot, datë 08.03.2018, lëshuar nga Bashkia Vlorë.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 19 prot, datë 10.02.2017, lëshuar nga Bashkia Gjirokastër.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 80 prot, datë 26.02.2018, lëshuar nga Bashkia Gjirokastër.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 500 prot, datë 10.02.2017, lëshuar nga Bashkia Korçë.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 1662 prot, datë 24.04.2018, lëshuar nga Bashkia Korçë.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 763 prot, datë 09.02.2017, lëshuar nga Bashkia Kurbin.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr extra prot, datë 01.03.2018, lëshuar nga Bashkia Kurbin.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 80 prot, datë 10.02.2017, lëshuar nga Bashkia Shkodër.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 426 prot, datë 27.02.2018, lëshuar nga Bashkia Shkodër.

- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 729 prot, datë 22.02.2017, lëshuar nga Bashkia Kukës.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 978 prot, datë 26.02.2018, lëshuar nga Bashkia Kukës.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, me nr 679 prot, datë 10.02.2017, lëshuar nga Bashkia Dibër.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, me nr 843/1 prot, datë 27.02.2018, lëshuar nga Bashkia Dibër.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.4.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.4.5. Neni 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se:

Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.4.6. Neni 5 “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë:

- a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;
- b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;
- c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;

III.4.7. Neni 9 i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Në taksat vendore përfshihen:

1. *Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.*
2. *Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.*
3. *Taksa e fjetjes në hotel.*
4. *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.*
5. *Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.*
6. *Shfuqizohet.*
7. *Shfuqizohet.*
8. *Taksa e tabelës.*
9. *Taksa të përkohshme.*

III.4.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.9. Referuar sa më sipër komisioni konstaton se në kriterin e veçantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 - 2018 për cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave në QKB. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk në përmbushje të këtij kriteri ky i fundit ka dorëzuar vërtetime lëshuar nga Bashkia Dibër me anë të të cilit konfirmohet se ofertuesi nuk ka detyrime të papaguara lidhur me taksat dhe tarifat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për këtë Bashki. Nga verifikimi i esktraktit të regjistrit tregëtar të ofertuesit të paraqitur rezulton se ky i fundit ka ushtruar aktivitet ekonomik për vitin 2017 në Bashkinë Dibër, për të cilën ka paraqitur vërtetimin përkatëse nga ku vërehet se nuk ka detyrime të papaguara lidhur me taksat dhe tarifat vendore për vitin 2017 dhe vitin 2018 për këtë Bashki. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik “Nazeri 2000” shpk, janë të pabazuara dhe jo në përputhje me kriteret e kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentat e procedurës së prokurimit dhe në bazë të verifikimit të vendeve të ushtrimit të aktivitetit në periudhën e kërkuar pasi ky është dhe qëllimi dhe fryma e ligjit që detyron subjektet të regjistrojnë vendet ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Në rastin konkret operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk për vitin 2017 rezulton të ketë ushtruar aktivitet edhe në Bashkinë Dibër, ku ka dorëzuar vërtetimin me nr 679 prot, datë 10.02.2017, lëshuar nga Bashkia Dibër, për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017 dhe vërtetimin

me nr 843/1 prot, datë 27.02.2018, lëshuar nga Bashkia Dibër për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2018, duke përmbushur tërësisht kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me kriteret për kualifikim për dorëzimin e vërtetimeve për shlyerjen e taksave vendore për selinë qendrore dhe niptet sekondare nëse ka të tilla. Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj Bashkisë Dibër ku ka ushtruar aktivitet.

Për sa më sipër pretendimi operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 200” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Kumria 1”, me arsyen se: [...] Se dyti, autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë Kumria pasi nuk kanë përmbushur kërkesën e AK sipas shtojcës 7 “Deklaratë Mbi Përmbushjen E Kriterëve Te Përgjithshme” ku të shprehet për emrat e Personave në cilesinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik që penale, to percaktuara në nenin 45/1 të LPP..[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 dhe 8 “Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 7

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomiksi më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së, të ndryshuar me ligjin nr.103/2018, realizohet ndërmjet paraqitjes së një vetedeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetedeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit.

Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.

III.5.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.), rezulton se operatori ekonomik “Kumria 1” sh.p.k. shpk ka dorëzuar të plotësuar shtojcën 7 deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithme të kualifikimit në përputhje me kriterin e kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 200” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Kumria 1”, me arsyen se: [...] Se treti, Autoriteti duhet të skualitkojë shoqërinë Kumria pass nuk ka përmbushur kërkesën e AK sipas shtojcës 1, formulari i ofertes pasi nuk ka plotësuar cmimin total dhe afatin si dhe nuk ka plotësuar vlerën totale në shifra dhe me pershkrim me fjale. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

*Emri i Ofertuesit*_____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroje ve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1	Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me tre turne 24 ore shtojca 11	24	1	4.98		
3	Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me dy turne 16 ore shtojca 11	24	3	3.32		
	Oferta Neto ne total					(X)
	TVSH (%)					(X)
	Oferta total					(X)

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Sqarime1

1. Ne çmim jane te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.

2. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.*

Nr.	Emërtimi
1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

Analiza e kostos

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*
- *Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).*
- *Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.*

Sqarime2

3. *Ne çmim jane te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me dy turne.*
4. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 2 turne (3.32 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.*

Nr.	Emërtimi
1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

Analiza e kostos

- Operatores janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me dy turne të llogaritet 3.32 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit).
- Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total.

III.6.2. Nga shqyrtimi i Formularit të Ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Kumria 1" sh.p.k. për këtë procedurë prokurimi KPP konstaton se oferta ekonomike pa tvsh në tërësinë e saj nuk shfaq asnjë gabim aritmetikor të asaj natyre që parashikon neni 66 i sipërcituar pasi nuk evidentohet asnjë pargullsi në veprimet aritmetikore të kryera nga ofertuesi. Në rastin konkret, Komisioni konstaton që mosvendosja nga ana e ofertuesit në formularin e ofertës konkretisht : tek "1.[...] [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH; 2.[...] [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH", por duke vendosur çmimin total të ofertës të përcaktuar me shifra nuk ndikon në vlefshmërinë e ofertës dhe as nuk e bën atë të pargullt, kur për më tepër në rastin e procedurave të prokurimit të shërbimit privat të sigurisë fizik , të cilat janë specifike në lidhje me procedurat e tjera, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë paraqitjen e preventivit dhe analizën e kostos, e cila është paraqitur nga ankimuesi ku lehtësisht është e verifikueshme që përlllogaritjet janë kryer sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi. Gjithashtu Komisioni konstaton se klasifikimi dhe kuotimi i ofertuesve në sistemin e prokurimeve elektronike bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total dhe akoma më tej autoriteti kontraktor në përcaktimin e vlerës së kontratës bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se oferta ekonomike e operatorit ekonomik "Kumria 1" sh.p.k. nuk përmban pasaktësi të tilla të cilat e bëjnë një ofertë të pavlefshme në kuptim të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 si më sipërcituar. Komisioni gjykon se në lidhje me

këtë ofertë autoriteti kontraktor ka gjykuar në përputhje me LPP-në dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 200” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Kumria 1”, me arsyen se: [...] Autoriteti duhet të skualifikoje shoqerine Kumria pasi nuk ka permbushur kerkesen e AK shtojca pika 2.3.2 pasi kjo shoqeri nuk ka paraqitur AKEP sipas kerkeses ne dst per radiokomunikim dhe alarm me zone mbulimi per vendet ku kerkohet sherbimi sipas specifikimeve teknike të dhena nga Ak ne dst tek shtojca 9 ku të perfshihet (Qarrisht, Librazhd, Prrenjas, Thane). [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.7.1. Në Shtojcën.7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika.2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

2.1.1 Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimin elektronike ne RSh” me zonë mbulimi vendi ku do te kryhet sherbimi.

III.7.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Kumria 1 ” sh.p.k., “në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar përkatësisht dokumentacionin si më poshtë:

- Shoqëria “Kumria 1 ” sh.p.k., Autorizim Individual me Nr.2078/1, datë 08.08.2018, ANEKS N° 2/1 (AKEP-2018-SRK-000299) “Për caktim dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sisteme Radiokomunikimi, Zona ku ofrohet shërbimi “Prrenjas -15 km”.
- Autorizim Individual me Nr.2078/1, datë 08.08.2018, ANEKS N° 3/1 (AKEP-2018-SRA-000251) “Për caktim dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sisteme Radioalarmi, Zona ku ofrohet shërbimi “Prrenjas -15 km”.
- Autorizim Individual me Nr.AI-U1593, datë 08.09.2014, ANEKS N° 2/1 (AKEP-2014-AI-U1593-1-4 “Për caktimin dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sistem Radiokomunikimi Zona ku ofrohet shërbimi “Qarku Elbasan - 50 km”.
- Autorizim Individual me Nr.AI-U1593, datë 15.01.2015, ANEKS N° 3/1 (AKEP-2014-AI-U1593-2-18 “Për caktimin dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sistem Radioalarmi Zona ku ofrohet shërbimi “Qarku Elbasan - 50 km”.

III.7.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.7.4. Në nenin 28 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose[...].”

III.7.5. Në nenin 66, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: "AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji."

Në këto autorizime, përcaktohet edhe zona e mbulimit (neni 70, pika 1, e Ligjit të lartpërmendur), ku përcaktohet se "Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban: a) të dhëna për përfituesin; b) frekuencat e përfituara; c) vendndodhjen dhe zonën e mbulimit; ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit; d) kushtet, që duhet të përmbushen për shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji".

III.7.6. Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Kumria 1” sh.p.k., me anë të dokumentacionit të paraqitur dëshmon se disponon autorizim për radiokomunikim dhe radioalarm të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare përkatësisht me zonë mbulimi vendndodhja e objektit të prokurimit, sipas përcaktimit të bërë në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

KPP gjykon se, operatori ekonomik “Kumria 1” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi me *Autorizimin Individual për caktim dhe përdorim frekuencash “Qarku Elbasan -50 km” si dhe “Prrenjas -15 km”*., referuar

vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, përfshin në frekuencë distancën reale të qytetit me vendin ku do të kryhet shërbimit të përcaktuar në Shtojcën 10, të dokumentave të tenderit,

III.7.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 200” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Kumria 1”, me arsyen se: [...]Autoriteti duhet të skualifikoje shoqerine Kumria pasi nuk ka përmbushur kërkesen e AK shtojca 8 pika 2.2.2 pasi nuk ka paraqitur vertetim nga pushteti vendore (Bashkite) ku të kete paguar taksat dhe tarifat vendore per vitin 2017 dhe 2018 per cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara ne QKB me niptin perkates.. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2, *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”* nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar:

Vërtetim nga pushteti vendore (Bashkit) që ka paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara ne QKB me niptin perkates.

III.8.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Kumria 1” shpk, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- *“Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” lëshuar më 22.02.2019, nga ku rezulton se zyra qendrore e shoqërisë “Kumria” sh.p.k është Elbasan.* -
- *Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017 dhe 2018 me nr. 160254/1 prot, datë 16.03.2018, lëshuar nga Bashkia Elbasan.*

- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2014,2015,2016 dhe 2017, me nr 08 prot, datë 07.04.2017, lëshuar nga Bashkia Elbasan.

III.8.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.8.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.8.5. Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se:

Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.8.6. Neni 5 “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë:

- a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;
- b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;
- c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;

III.8.7. Neni 9 i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Në taksat vendore përfshihen:

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.
3. Taksa e fjetjes në hotel.

4. *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.*
5. *Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.*
6. *Shfuqizohet.*
7. *Shfuqizohet.*
8. *Taksa e tabelës.*
9. *Taksa të përkohshme.*

III.8. 8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.8.9. Referuar sa më sipër komisioni konstaton se në kriterin e veçantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 - 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave në QKB. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Kumria 1" shpk në përmbushje të këtij kriteri ky i fundit ka dorëzuar vërtetime lëshuar nga Bashkia Elbasan me anë të të cilit konfirmohet se ofertuesi nuk ka detyrime të papaguara lidhur me taksat dhe tarifat vendore për vitin 2017 dhe 2018 për këtë Bashki. Nga verifikimi i ekstraktit të regjistrit tregëtar të ofertuesit të paraqitur rezulton se ky i fundit ka ushtruar aktivitet ekonomik për vitin 2017 dhe 2018 në Bashkinë Elbasan, për të cilën ka paraqitur vërtetimin përkatës nga ku vërehet se nuk ka detyrime të papaguara lidhur me taksat dhe tarifat vendore për vitin 2017 dhe vitin 2018 për këtë Bashki. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimes "Nazeri 2000" shpk, janë të pabazuara dhe jo në përputhje me kriteret e kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor vlerëson ofertat e operatorëve ekonomikë në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentat e procedurës së prokurimit dhe në bazë të verifikimit të vendeve të ushtrimit të aktivitetit në periudhën e kërkuar pasi ky është dhe qëllimi dhe fryma e ligjit që detyron subjektet të regjistrojnë vendet ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Në rastin konkret operatori ekonomik "Kumria 1" shpk për vitin 2017 dhe 2018 rezulton të ketë ushtruar aktivitet edhe në Bashkinë Elbasan, ku ka dorëzuar vërtetimet e sipërcituara nga Bashkia Elbasan, për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017 dhe 2018 duke përmbushur tërësisht kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me kriteret për kualifikim për dorëzimin e vërtetimeve për shlyerjen e taksave vendore për selinë qendrore dhe niptet sekondare nëse ka të tilla (që në rastin konkret ky operator ekonomik nuk ka). Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik "Kumria 1" sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj Bashkisë Elbasan ku ka ushtruar aktivitet.

Për sa më sipër pretendimi operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 200” sh.p.k. mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III. gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. do të vijojë të mbetet e skualifikuar nga procedura në fjalë edhe pas ankimimit në KPP, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” për operatorët ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k. dhe “Bahiti – G”sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 19.03.2019, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jenë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. për operatorët ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k. dhe “Bahiti –G”sh.p.k. nuk do të merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-06170-02-04-2019 me objekt, “Shërbim i ruajtjes së objekteve me roje private Sh. A Ujësjellës Kanalizime Librazhd”, me fond limit 20.015.540 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 07.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Sh. a Ujësjellës Kanalizime Librazhd.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 549 Protokolli; Datë 28.03.2019

Nr. 590 Protokolli; Datë 01.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar
Vilma Zhupaj**

**Anëtar
Merita Zeqaj**

**Kryetar
Evis Shurdha**